

VENDIM
Nr.849, datë 21.10.2010

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.71, DATË 3.2.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË
PËRKOHSHME, PËR VITIN 2010, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 1 të vendimit nr.71, datë 3.2.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:

“1.1. Numrit të përgjithshëm të punonjësve me kontratë të përkohshme, sipas pikës 1, i shtohet numri prej 4 (katër) punonjësish, sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga shpenzimet korente, të miratuara në buxhetin përkatës të vitit 2010, të njësive të qeverisjes qendrore.

3. Ngarkohet Ministria e Financave të miratojë detajimin e numrit të punonjësve, sipas lidhjes nr.2, të përmendur në pikën 1.1, brenda kritereve të vendimit nr.1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme për ministrinë dhe institucionet buxhetore.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e miratimit të tij.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.2

Gr.	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare	Muajt
	Ministria e Financave	3			
	Sektori i pagesave të dëmshpërblimeve	1	Punonjës arkivi	8 orë/ditë	tetor-dhjetor
	Drejtorja e Financimeve, Kontraktimeve/dega e thesarit Tiranë	1	Roje	8 orë/ditë	tetor-dhjetor
	Drejtorja e Parandalimit të Pastrimit të Parave	1	Punonjës arkivi	8 orë/ditë	tetor-dhjetor
	Zyra e Administrimit Gjyqësor	1			
	Zyra e Administrimit Gjyqësor	1	Sanitar	3-4 orë/ditë	tetor-dhjetor
	Total-Numri i punonjësve	4			